



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1200/2 prot.

Tiranë, më 30. 10. 2020

V E N D I M

Nr. 154, datë 30. 10. 2020

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 114, datë 13.10.2020, e shtetasit Xh. L., kundër Bashkisë Klos, në të cilën pretendon për diskriminim *për shkak të bindjeve politike¹ dhe gjendjes shëndetësore²*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi ka sqaruar se, në datën 30.04.2018, është punësuar pranë Bashkisë Klos në pozicionin “*Punonjës shërbimi për vaditjen me kontratë*”. Ne vijim, në datën 01.11.2018, është transferuar në pozicionin “*Punëtor në sektorin e rrugëve rurale*”. Në fillim të muajit prill 2020, ankuesi ka qënë me raport për paaftësi të përkohshme në punë dhe nepërmjet shërbimit postar është vënë në dijeni të shkresës nr. 891 prot., datë 03.04.2020, nga Bashkia Klos, mbi njoftimin për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Sipas kësaj shkrese, Bashkia Klos, citon se marrëdhëniet e punës me ankuesin kanë përfunduar në datën 05.02.2020, por për shkak të raportit të paaftësisë së përkohshme në punë, zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk është bërë, kjo bazuar në nenin 147 pika 1 e Kodit të Punës.

¹ Referuar vërtetimit Nr. 58 prot., datë 23.08.2020, të lëshuar nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Mat, ankuesi rezulton të jetë anëtarë i saj që prej vitit 1991 e në vijim.

² Referuar Raportit për Paaftësi të Përkohshme në Punë, ankuesi pretendon se është larguar nga detyra gjatë kohës që ka qënë me paaftësi të përkohshme në punë.

Sipas ankuesit, duke ndjekur këtë mënyrë të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, Bashkia Klos, ka vepruar në kundërshtim të hapur me procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi i Punës. Pretendohet që Bashkia Klos, i ka dërguar ankuesit vetëm këtë shkresë dhe asnjë njoftim tjetër paraprak, sikundër parashikohet në Kodin e Punës. Gjatë kësaj kohe Xh. L. sqaron se ka qënë me raport për paaftësi të përkohshme në punë, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë nga ana e Bashkisë Klos. Konkretisht, ai thekson faktin se ai ka qënë me raport paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore nga data 3 deri në datën 9 prill 2020. Pavarësisht këtij fakti, zyrtarët e Bashkisë Klos, kanë vijuar procedurën për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Sipas ankuesit, punëdhënësi është bërë pengesë edhe për t'i vënë në dispozicion atij një kopje të librezës së punës dhe dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e të ardhurave nga papunësia. Megjithatë, me anë të postës punëdhënësi i ka vënë në dispozicion librezën e punës, ku është vënë në dijeni se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me të ishte bërë më datë 06.04.2020, ndërkohë që ai pretendon se deri më datë 09.04.2020, ka qënë me raport paaftësie në punë.

Xh. L. sqaron se, veprimet e Bashkisë Klos kanë sfond politik, kjo edhe për arsye të pozicionimit të tij prej 30 vitesh, si themelues dhe aktivist i Partisë Demokratike në ish-Komunën Gurrë. Ai pretendon se nga ana e drejtuesve të Bashkisë Klos i është thënë disa herë në rrugë verbale se *“ne nuk kemi vend për ty, ti e kupton këtë gjë”*, ndërkohë që gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën ndaj tij nuk është marrë asnjë masë disiplinore apo vërejtje. Madje shton se, Bashkia Klos edhe gjatë periudhës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me ankuesin, ka rekrutuar punonjës të tjerë në pozicione të ngjashme me të.

I gjendur para këtij fakti të Bashkisë Klos, duke qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore, por edhe në kushtet e kufizimit maksimal të lëvizjeve për shkak të gjëndjes së emergjencës të shkaktuar nga Covid-19, ankuesi pretendon se ka komunikuar me drejtuesit kryesorë të Bashkisë (Kryetar, zëvendëskryetare dhe punonjës të burimeve njerëzore) nëpërmjet telefonit (biseda telefonike por edhe mesazhe), si të vetmet mjete të mundshme komunikimi në kushtet e emergjencës së Covid-19. Nëpërmjet bisedave telefonike dhe mesazheve, ankuesi pretendon se ka vënë në dijeni përfaqësuesit e Bashkisë Klos, se e ka të pamundur për shkak të gjëndjes shëndetësore të dalë në punë, por kjo gjë nuk është marrë parasysh nga ana e tyre.

Sipas tij, këto fakte dëshmojnë se jemi para një situatë të diskriminimit për shkak të gjëndjes shëndetësore dhe bindjeve politike.

Në përfundim, Xh. L. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, si dhe vendosjen e sanksioneve administrative ndaj Bashkisë Klos.

Në datat 15.10.2020 dhe 26.10.2020, ankuesi vuri në dispozicion të shqyrtimit të ankesës, prova shtesë dhe informacion lidhur me shkaqet dhe objektin e ankesës për diskriminim.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në Ankimin Civil, drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, Komisioneri u vu në dijeni të kërkesë padisë së Xh. L., paraqitur kundër institucionit të Bashkisë Klos. Referuar parashtimeve të bëra në kërkesë padi, Komisioneri u vu në dijeni të faktit se, pretendimet e ankuesit për diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes shëndetësore, ankuesi i ka bërë objekt shqyrtimi gjyqësor.

Kjo reflektohet në kërkesë-padinë, datë 26.10.2020, paraqitur para gjykatës kompetente nga vetë subjekti ankues, në parashtimet dhe kërkimet e tij. Kështu, në parashtimet³ e kërkesë padisë, ka referuar, ndër të tjera: *“...Për gjykimin e ankuesit, këto veprime dhe mosveprime të Bashkisë Klos ndaj paditësit Xh. L., shtojnë dyshimin e arsyeshëm se ky shtetas është diskriminuar për*

³ Faqja 3, paragrafi 2, 3 dhe 4

bindjet e tij politike, që i manifeston në mënyrë të hapur. Lidhur me këtë, e nderuar Gjykatë, sjellim në vëmendjen tuaj sa vijon: Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) parashikon në nenin 1 të tij shkaqet për të cilat diskriminimi është i ndaluar. Këto janë: gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, mosha, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër...etj. Referuar këtij nënvizimi paditësi është diskriminuar nëse është trajtuar në mënyrë të pafavorshme, të padrejtë, të paligjshme, krahasuar me një person tjetër, në rrethana të njëjta apo të ngjashme dhe si shkak për këtë trajtim ka shërbyer në rastin konkret bindja politike...”

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana që janë paraqitur përpara Komisionerit, bëhen prezent edhe në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës⁴.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: “...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërkimeve të padisë gjendet në pjesës përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen.

Në kontekst të sa më sipër, në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte e rrethana janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor; atëherë konform nenit 36, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Civile, prevalon shqyrtimi dhe vendimmarrja e këtij të fundit.

⁴ Shih faqen nr. 3, të kërkesë padisë së ankuesit drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë.

Përsa më sipër, në kushtet kur kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkaqet e pretenduara prej tij.

Bazuar në nenin 36, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht se: “3. Gjykata e njofton Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim. 4. Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), nenin 90, pika 3 e Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, si dhe referuar neneve 12-13, nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36 e vijues të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën e hetimit të ankesës Nr. 144, datë 13.10.2020, të Xh. L., pasi çështja e parashtruar në ankesën e mësipërme, me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt, është duke u gjykuar nga Gjykata e Apelit Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shëndetësore dhe bindjet politike)
(Fusha: Punësim)